



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

**RAPORT I MONITORIMIT TË STRATEGJISË
KOMBËTARE KUNDËR MASHTRIMIT PËR MBROJTJEN E
INTERESAVE FINANCIARE TË BASHKIMIT EVROPIAN,
2025-2030
DHE PLANI I VEPRIMIT TË SAJ,
PËR VITIN 2025**



Parandalim



Zbulim



Korrigjim

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1.1 Metodologjia e monitorimit.....	4
1.2 Konsultimi me institucionet.....	5
1.3 Raportim mbi zbatimin e planit të veprimit.....	6
1.4 Progresi aktual.....	6
1.5 Ndikimi i zbatimit të SKKM-së, në përputhje me axhendën e Integritit Evropian.....	7
1.6 Raportimi mbi zbatimin e Planit të Veprimit.....	8
1.7 Shkalla e realizimit të aktiviteteve të parashikuara, për vitin 2025.....	21
1.8 Indikatorët e performancës.....	22
1.9 Buxheti dhe kostot financiare, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit.....	27
1.10 Fushat ku janë identifikuar problematika gjatë implementimit.....	27
Lista e akronimeve.....	29

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.275, datë 09.05.2025 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian, 2025-2030 dhe planit të saj të veprimit”, është miratuar Strategjia e parë Kombëtare e Shqipërisë Kundër Mashtrimit, botuar në Fletoren Zyrtare nr.88, datë 23.05.2025.

Ky dokument pasqyron angazhimin politik të Shqipërisë në luftën kundër parregullsive dhe mashtrimeve, duke nxitur besimin në institucionet publike dhe siguruar përdorimin e fondeve të BE-së në mënyrë efektive dhe në zbatim të plotë të kuadrit ligjor të Bashkimit Evropian dhe atij vendas, dhe jo vetëm.

Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit (SKKM) 2025-2030, specifikon qasjen e plotë që ka Shqipëria për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe sigurimin e administrimit e shëndetshëm të fondeve të BE-së gjatë periudhës së saj të para-anëtarësimit. Kjo strategji është në pajtim me direktivat e BE-së dhe objektivat kombëtare, që krijon bazën për përpjekjet e Shqipërisë në luftën kundër parregullsive dhe mashtrimeve.

Qëllimi kryesor i SKKM-së është të rrisë parandalimin, zbulimin dhe kushtet për hetimin e mashtrimit, duke siguruar njëkohësisht nivele të duhura të rregullimit dhe parandalimit.

SKKM-ja luan një rol thelbësor në përmirësimin e efektshmërisë së buxhetit nga fillimi i procesit deri tek përfituesi përfundimtar. Ajo është pjesë e një qasjeje tërësore për luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit, që plotëson iniciativat e fundit të paraqitura nga Komisioni Evropian për përfshirjen në programe të ndryshme financimi të BE-së masat e duhura kundër mashtrimit.

Siç përshkruhet në nenin 74, të Rregullores së Dispozitave të Komisionit, vendet duhet të zbatojnë masa të efektshme dhe proporcionale kundër mashtrimit, duke marrë parasysh rreziqet e identifikuar dhe të 'parandalojnë, zbulojnë dhe korrigjojnë parregullsitë'. Këto përgjegjësi janë ndër detyrimet më të rëndësishme për shtetet anëtare.

Autoritetet përkatëse angazhohen të drejtojnë duke dhënë shembull gjatë gjithë periudhës së programimit, duke siguruar që fondet e BE-së të arrijnë tek përfituesit e duhur dhe të përdoren për qëllimet e tyre të synuara. Në zbatimin e këtij objekti, autoritetet do të bëjnë përpjekje të përdorin sa më mirë mjetet aktualisht të disponueshme, si dhe çdo mjet të ri të paraqitur gjatë periudhës së programimit.

Objektivat specifike të kësaj SKKM-je mbulojnë të gjitha fazat e ciklit kundër mashtrimit dhe janë si më poshtë:

1. Krijimi i një mjedisi kundër mashtrimit nëpërmjet forcimit të kuadrit ligjor.
2. Forcimi i parandalimit të mashtrimit, nëpërmjet përmirësimit të ndërgjegjësimit dhe promovimit të etikës në institucionet publike.

3. Maksimizimi i masave të zbulimit, raportimit dhe korrigjimit, për trajtimin e parregullsive në mënyrë të efektshme.
4. Forcimi i kapaciteteve të hetimit dhe ndjekjes penale, veçanërisht përmes bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.
5. Sigurimi i mekanizmave të efektshme të rikuperimit, për minimizimin e humbjeve financiare.

1.1 Metodologjia e monitorimit

Me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.89, datë 30.06.2025 “Për ngritjen Komitetit drejtues, për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së 2025-2030 dhe Planit të saj të veprimit” është ngritur Komiteti drejtues i cili do të monitorojë zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian, 2025-2030 dhe planit të saj të veprimit. Komiteti drejtues udhëhiqet nga Zyrtari Kombëtar Autorizues/Zëvendësministri për Financat dhe ka në përbërje të tij përfaqësues nga 13 institucione/struktura që lidhen me zbatimin e këtij dokumenti strategjik dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Komiteti Drejtues mblidhet të paktën një herë në vit.

Një ndër kompetencat e Komitetit Drejtues është edhe miratimi i Raportit vjetor të monitorimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së 2025-2030.

Raporti vjetor, i monitorimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian, 2025-2030 dhe planit të saj të veprimit, për vitin 2025, përfshin periudhën Qershor-31 Dhjetor 2025. Ky raport pasqyron progresin e arritur në zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të parashikuara për këtë periudhë, shërben si mjet monitorimi, vlerësimi, si dhe shërben për identifikimin e mangësive dhe në vijim të veprimeve që do të propozohen për trajtimin e këtyre mangësive.

Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik/AFCOS, pranë Ministrisë së Financave ka udhëhequr procesin e hartimit të këtij raporti, si detyrim i VKM-së nr. 275, datë 09.05.2025 dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr.89, datë 30.06.2025 “Për ngritjen Komitetit drejtues, për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së 2025-2030 dhe Planit të saj të veprimit”.

Drejtorja e Inspektimit Financiar Publik/AFCOS dërgon kërkesën për raportim të gjithë udhëheqësit e objektivave, të cilët janë struktura përgjegjëse për raportimin mbi zbatimin e Strategjisë kundrejt planit të veprimit të miratuar, performancën kundrejt objektivave, çdo vonesë; ose ndryshime, duke identifikuar risqet e materializuara dhe masat e tyre lehtësuese. Vlerësimi i progresit të zbatimit të SKKM për këtë periudhë raportimi është kryer nga DIFP përmes analizës së të dhënave të përcjella nga institucionet raportuese.

Së pari, është analizuar zbatimi i aktiviteteve duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre.

Së dyti, është analizuar arritja e vlerës së synuar për vitin 2025 e përcaktuar në treguesit e performancës duke vlerësuar arritjen e vlerës së synuar.

Së treti, është analizuar realizimi i objektivave specifike përmes përlogaritjes së realizimit të treguesve.

Për përlogaritjen e realizimit të objektivave specifike sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës është përdorur formula si më poshtë:

$$NR = (TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR) / (2\ TP) \times 100\%$$

Në këtë formulë NR është niveli i realizimit dhe TP – treguesi i performancës.

Struktura e Raportit të monitorimit vjetor 2025, është hartuar në përputhje me metodologjinë IPSIS bazuar në vlerësimin e progresit të SKKM-së, i cili bëhet në dy nivele: niveli i arritjeve të treguesve të performancës dhe në nivelin e aktivitetit.

Shkalla e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën më poshtë.

Kategoria	Niveli i tolerancës
Dobët	Nga 0 deri në 30 % e aktiviteteve të realizuara
Mjaftueshëm	Nga 31 deri në 50 % e aktiviteteve të realizuara
Mirë	Nga 51 deri në 85 % e aktiviteteve të realizuara
Shumë mirë	Nga 86 deri në 110 % e aktiviteteve të realizuara
Tejkaluar	111% e lart

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve nëpërmjet pikave të kontaktit, mbi zbatimin e aktiviteteve, masave dhe matjen e treguesve të objektivëve strategjikë, për të cilat janë përgjegjëse; si dhe
2. Raportimi mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij para Komitetit Drejtues.

1.2 Konsultimi me institucionet

Në përputhje me kërkesat e SKKM-së dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr.89, datë 30.06.2025, pas hartimit të raportit, ky draft raport do të paraqitet për miratim në mbledhjen e Komitetit Drejtues. Procesi i analizimit dhe hartimit të draft raportit u shoqërua me tryeza teknike pune diskutimi dhe vlerësimi raportimesh nga stafi teknik së bashku me institucionet zbatuese dhe raportuese të Planit të Veprimit.

Korniza institucionale për zbatimin dhe monitorimin e SKKM përfshin një Komitet Drejtues (KD), një Grup teknik pune, për monitorimin e saj, si dhe Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik, në cilësinë e kordinatorit të procesit dhe Sekretariatit Teknik të monitorimit të këtij dokumenti strategjik.

Më datë 24.09.2025, u organizua mbledhja e Grupit teknik të punës, përgjegjës për monitorimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve të SKKM-së, kryesisht për vitin 2025. Pjesë e këtij takimi ishin të gjithë aktorët e përfshirë në monitorimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Bashkimit Evropian dhe planit të saj të veprimit. Ndër të tjera anëtarëve të grupit teknik të monitorimit të SKKM-së u bënë me dije se në përputhje me planin e veprimit do të raportojnë për zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave në përputhje me udhëzimet e dhëna nga drejtuesi i masës respektive. Bazuar në raportimet e këtyre subjekteve, do të hartohet dhe shpërndahet çdo vit raporti vjetor i monitorimit mbi zbatimin e SKKM-së, i cili do të përfshijë rekomandimet e treguesve, analizën cilësore të rezultateve të arritura si dhe identifikim të mangësive dhe veprimet e propozuara për trajtimin e këtyre

Më datë 19.12.2025, u zhvillua takim i Komitetit Drejtues të SNKK, me prezencë të të gjithë përfaqësuesve të institucioneve raportuese, për të diskutuar mbi metodologjinë e monitorimit të kryer, vlerësimin dhe analizën e informacionit të marrë, problematikën, sfidat dhe raportimin në vijim. Takimi u drejtua nga Zyrtari Kombëtar Autorizues/Zëvendësministri për Financat.

Në vijim do të paraqitet draft raporti pranë Komitetit Drejtues, për vlerësim dhe miratim.

1.3 Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit

Çdo subjekt i specifikuar drejtues në planin e veprimit raporton periodikisht pranë AFCOS-it për zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave në përputhje me udhëzimet e dhëna. Bazuar në të dhënat që jepen nga subjekte të ndryshme, AFCOS harton dhe shpërndan raportin vjetor të monitorimit mbi zbatimin e SKKM-së. Raporti vjetor i monitorimit përfshin rekomandimet e treguesve, analizën cilësore të rezultateve të arritura si dhe identifikimin e mangësive dhe veprimet e propozuara për trajtimin e këtyre mangësive.

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në cilësinë e AFCOS dhe sekretariatit të ngarkuar për zbatimin e SKKM-së, në kuadër të procesit të përgatitjes së raportit vjetor të monitorimit të SKKM-së 2025-2030 dhe në vijim të raportimeve nga të gjithë strukturat drejtuese përgjegjëse për

raportimin mbi zbatimin e strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancës ndaj objektivave, ka përgatitur këtë raport bazuar në detyrimin që rrjedh nga SKKM.

Të gjitha institucionet dhe strukturat e ngarkuara për zbatimin e Objektivave, masave dhe aktiviteteve të këtij dokumenti strategjik, me kërkesën e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik kanë nominuar dhe përcjellë anëtarët e grupit Teknik të punës, të cilët raportojnë tek institucioni/struktura drejtuese për masën respektive, në kuadër të monitorimit të zbatimit të saj.

Referuar Aneksit nr.2, “Plani i veprimit për periudhën 2025-2027”, **në tërësi për periudhën 2025-2027 janë parashikuar 5 objektiva, 15 masa dhe 39 aktivitete.** Disa aktivitete fillojnë në periudhën 2025-2027, por planifikohen të përfundojnë në periudhën 2028-2030. Për ato aktivitete për zbatimin e të cilave, janë përgjegjëse disa institucione, institucioni drejtues koordinon zbatimin e aktivitetit me palët e tjera të interesuara dhe i raporton AFCOS-it mbi progresin.


- Treguesit kryesorë të performancës janë identifikuar për secilën masë dhe shtjellohen më tej në Aneksin 3.
- Në përputhje me metodologjinë për përgatitjen e SKKM-së, të hartuar nga OLAF, risqet që zbuten ose ndryshe trajtohen nga çdo masë paraqiten në këtë plan veprimi.
- Në përputhje me metodologjinë për përgatitjen e SKKM-së, të nxjerrë nga OLAF-i, burimet identifikohen në terma të përgjithshëm. Aneksi 4 përfshin një kosto më të detajuar.

Lidhur me vlerësimin e masave dhe aktiviteteve, jepet një përmbledhje e shkurtër dhe e qartë e progresit të zbatimit, ose një shpjegim i çdo mungese progresi, për periudhën raportuese.

1.4 Progresi aktual


Plani i veprimit për vitin 2025, përmban në total 12 indikatorë dhe 16 Aktivitete. Zbatimi i planit të veprimit vlerësohet të ketë patur pritshmërinë e duhur. Aktualisht nga 16 aktivitete, janë realizuar plotësisht 14 prej tyre dhe vijojnë realizimin/ janë në proces realizimi sikurse është planifikuar 2 aktivitete.

Grafiku 1. Statusi i realizimit të Aktiviteteve



Gjithashtu pjesa më e madhe e treguesve të performancës janë arritur. Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparim të mirë në zbatimin e Strategjisë së saj kundër mashtrimit me fondet e BE-së. Përparimi i SKKM-së ka qenë shumë i mirë, me një nivel realizimi prej 96.25 % referuar Indikatorëve të Performancës të arritur plotësisht. Në mënyrë të përmbledhur grafiku sa më poshtë paraqet nivelin e realizimit të objektivave referuar treguesve të performancës:

Grafiku 2. Statusi i realizimit të objektivave referuar indikatorëve të performancës.



1.5 Ndikimi i zbatimit të SKKM-së, në përputhje me axhendën e Integritimit Evropian.

Hartimi dhe miratimi i “Strategjisë Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiare të BE-së, 2025-2030” (SKKM), është detyrim që rrjedh nga procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, referuar rekomandimeve të paraqitura në Progres Raportet e Bashkimit Evropian për Shqipërinë, Kapitulli 32 “Kontrolli financiar”, nënkapitulli “Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Evropian”, si dhe në kërkesat e Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF), e cila, në funksion të mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, ka kërkuar nga shtetet anëtare, si dhe nga vendet aderuese që të zhvillojnë dhe zbatojnë një Strategji Kombëtare Kundër Mashtrimit.

Në kuadrin e integritetit në BE, Shqipëria po përafrohet legjislativisht me standardet e BE-së kundër mashtrimit, veçanërisht nënkatëse të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, konventën dhe rregulloret që synojnë sigurimin e mbrojtjes së interesave financiare të Komuniteteve Evropiane, rregulloret që përcaktojnë kushtet për menaxhimin e qëndrueshëm financiar dhe rregulloret specifike të nxjerra nga Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Kjo strategji është përgatitur në përputhje me standardet e vendosura nga udhëzimet e BE-së dhe parashikon përafrimin e mëtejshëm të legjislativisht shqiptar në fushën e drejtësisë, administratës

publike, antikorrupsionit, menaxhimit të financave publike dhe prokurimeve, me kërkesat e BE-së.

Ky dokument parashtron Strategjinë e parë Kombëtare të Shqipërisë Kundër Mashtrimit (në tekstin e mëtejme SKKM), që vë theksin mbi synimet e autoriteteve kompetente shqiptare në fushën e parandalimit dhe luftës kundër parregullsive dhe mashtrimeve që prekin interesat financiare të BE-së, e cila mbulon periudhën 2025-2030. SKKM-ja është në linjë me iniciativat për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe ofron strategjinë dhe objektivat dhe veprimet kryesore kundër mashtrimit që duhen zbatuar nga autoritetet kompetente në lidhje me të gjithë ciklin kundër mashtrimit, që përfshin parandalimin, zbulimin dhe hetimin e mashtrimit, si dhe masat korigjuese dhe sanksionet.

Kjo SKKM është hartuar në përputhje me: (i) Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026, seksioni në Kapitullin 32 “Kontrolli Financiar”, Nënkapitulli “Mbrojtja e Interesave Financiare të BE-së”, (ii) Strategjinë Sektoriale të Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030, seksioni mbi Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, nën seksioni mbi Inspektimin Financiar Publik dhe Shërbimin e Koordinimit Kundër Mashtrimit dhe (iii) Strategjinë Kombëtare Kundër Mashtrimit.

Strategjia Kombëtare Anti-Mashtrim është e lidhur ngushtë me planet strategjike më të gjëra të Shqipërisë për zhvillim, integrimin evropian dhe qeverisjen e mirë. Ajo vepron si element kyç në sigurimin e përdorimit efektiv dhe transparent të fondeve publike dhe demonstrimin e gatishmërisë për anëtarësimin në BE.

1.6 Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimit.

Për periudhën raportuese, lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit SKKM 2025-2027, janë parashikuar objektivat, masat dhe aktivitetet respektive, referuar Aneksit nr.2, “Plani i veprimit për periudhën 2025-2027”, të cilat në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen, për sa vijon:

- ***Për Objektivin 1: Sigurimi i një mjedisi të mbrojtur nga mashtrimi përmes krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm, janë parashikuar 3 masa dhe 7 aktivitete, për gjithë periudhën 2025-2027.***

Ky objektivi përfshin, konkretisht masat, sa vijon:

Masa 1.1 Kryerja e një analize të kuadrit ligjor që rregullon interesat financiare të BE-së në bashkëpunim me organet zbatuese, hetuese dhe gjyqësore, duke siguruar përafrim me kërkesat dhe praktikatat e mira aktuale dhe të mundshme të BE-së, **parashikuar për t’u zbatuar në periudhën 2025-2026.**

Masa 1.2 Në varësi të rezultateve të analizës së kuadrit ligjor që rregullon interesat financiare të BE-së, hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në rregulloret ekzistuese ose miratimi i rregulloreve të reja, **parashikuar për t’u zbatuar në periudhën 2027-2028.**

Masa 1.3 Përditësimi i rrjetit AFCOS dhe përditësimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të

institucioneve të përfshira në rrjetin AFCOS (Urdhër i Ministrit të Financave),
parashikuar për t'u zbatuar në periudhën 2025-2028.

Për vitin 2025 janë parashikuar masat dhe aktivitete sa vijon:

Lidhur me zbatimin e **masës 1.1**, janë parashikuar 2 aktivitete, nga të cilat:

Për vitin 2025-2026 është parashikuar **Aktiviteti 1.1.1**, “Të kryhet një analizë e kuadrit ligjor aktual, për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e mashtrimit”. Për periudhën respektive të vitit 2025, nga ana e Drejtorisë Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (DMZKA), në cilësinë e institucionit drejtues, në bashkëpunim me institucionet/strukturat e tjera të ngarkuara për zbatimin e këtij aktiviteti (AFCOS, MD, SASPAC, organet e IPA/IPARD, PP, SPAK, Policia e Shtetit Shqiptar, MSHAPA, dhe autoritetet e tjera kompetente), raportohet se analiza paraprake e kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e parandalimit të mashtrimit është përgatitur. Për periudhën raportuese, analiza është hartuar si dokument pune dhe është përcjellë për konsultim tek institucionet përkatëse.

Konsultimi është në proces, duke synuar marrjen e inputeve të munguara dhe finalizimin brenda periudhës së përcaktuar në Planin e veprimit.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezulton i zbatuar.

Përsa i përket **Aktivitetit 1.1.2** “Të bëhet raportimi tek institucionet/organet përkatëse”, ky aktivitet është parashikuar të realizohet gjatë vitit 2026.

Analiza e kuadrit ligjor do të shërbejë si referencë për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor sikurse parashikuar në Masën 1.2 e cila është parashikuar për t'u zbatuar në periudhën 2027 -2028.

Lidhur me **masën 1.3**, janë parashikuar 2 aktivitete nga të cilat:

Për vitin 2025-2026, është parashikuar **Aktiviteti 1.3.1** “Të kryhet një analizë e përbërjes së Rrjetit AFCOS dhe të raportohet tek Autoriteti ligjor përgjegjës”. Nga ana e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik, për të siguruar një mjedis efektiv kundër mashtrimit ka përfunduar procesi, i cili përfshinte përditësimin e institucioneve, të cilët aktualisht janë pjesë e Rrjetit AFCOS, por kanë ndryshuar emërtimin, fushën e përgjegjësisë, etj, si dhe përfshirjen e institucioneve të reja, me autoritetet kombëtare të përfshira në parandalimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsive, për lehtësimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse në Bashkimin Evropian, në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian. Janë identifikuar institucionet/strukturat respektive të cilat në vijim gjatë vitit 2026 do të raportohen pranë Ministrit të Financave, në cilësinë e Autoritetit ligjor përgjegjës, për të vijuar me ndryshimet dhe përditësimet respektive, të institucioneve në Rrjetin AFCOS. Në vijim do të kryhet një analizë tërësore e marrëveshjeve ekzistuese të bashkëpunimit, me fokus të veçantë detyrimet e Shqipërisë për të mbrojtur interesat financiare të BE-së, si dhe do të lidhen

marrëveshje të reja bashkëpunimi, me institucionet e tjera që do të përfshihen në këtë rrjet. Këto detyrime janë të parashikuara në aktivitetin 1.3.2 për t'u zbatuar në periudhën 2026-2028.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezultoi i zbatuar.

Lidhur me treguesit e performancës:

Për këtë objektivi për vitin 2025 është parashikuar një tregues performance sa vijon:

Indikator	Vlera bazë	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi specifik 1: Sigurimi i një mjedisi të mbrojtur nga mashtrimi nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm.			
1	TKP 1.3.1 Analiza e Rrjetit AFCOS.	-	Analiza filluar. Realizuar 100%.

Niveli i realizimit të objektivit 1.

Niveli i realizimit të Objektivit specifik 1: Sigurimi i një mjedisi të mbrojtur nga mashtrimi nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën qershor - dhjetor 2025 është **100%**. **Gjithashtu edhe aktivitetet e parashikuara për këtë periudhë, sa më sipër trajtuar hollësisht rezultojnë të realizuara.**

Shkalla e realizimit të objektivit 1 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë**. Aktivitetet e parashikuara janë realizuar në masën 100%.

Objektivat	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2025			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Aktivitete plotësisht të realizuara	Aktiviteteve në proces realizimi	Aktivitete të pa realizuara
Objektivi 1	Masa	2	2	-	-
	Aktivitete	2			

- ***Për Objektivin 2: Nxitja e parandalimit të mashtrimit midis zyrtarëve publik dhe publikut, ka të parashikuara 5 masa dhe 11 aktivitete.***

Ky objektivi përfshin, konkretisht masat, sa vijon:

Masa 2.1 Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve publike dhe publikut për parandalimin e parregullsive dhe rasteve të dyshimta të mashtrimit. Periudha e zbatimit 2025-2027.

Masa 2.2 Promovimi i etikës dhe integritetit në administratën publike veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Periudha e zbatimit 2025-2027.

Masa 2.3 Përditësimi i planeve të integritetit të institucioneve/organeve publike përkatëse të ngarkuara me mbrojtjen e interesat financiare të BE-së. Periudha e zbatimit 2025-2027.

Masa 2.4 Integrimi i menaxhimit të riskut të mashtrimit me kuadrin aktual të menaxhimit të riskut të miratuar nga institucionet/organet përkatëse të ngarkuara me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Periudha e zbatimit 2026-2027.

Masa 2.5. Rritja e Angazhimit të Shoqërisë Civile dhe Forcimi i Mekanizmave të Raportimit të Mashtrimeve. Periudha e zbatimit 2025-2027.

Për vitin 2025

Lidhur me zbatimin e **Masës 2.1**, është parashikuar:

Aktiviteti 2.1.1 “Publikimi i informacionit të përditësuar në faqet përkatëse zyrtare, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me parregullsitë dhe rastet e dyshimta të mashtrimit në lidhje me përdorimin e fondeve të BE-së”. Ky aktivitet është parashikuar për t’u zbatuar në periudhën 2025-2027. Për periudhën raportuese nga ana e Drejtorisë Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (DMZKA), në cilësinë e institucionit drejtues në bashkëpunim me institucionet/strukturat e tjera të ngarkuara për zbatimin e këtij aktiviteti (AFCOS, AZHBR, NJQFK, AA, SASPAC, MSHAPA dhe autoritetet e tjera kompetente), raportohet se po punohet në këtë drejtim. Aktualisht AZHBR, CFCU, DIFP/AFCOS, AA, MASHPA, kanë link të dedikuar në faqet zyrtare respektive, i cili mundëson raportimin e parregullsive dhe rasteve të dyshuara të mashtrimit. Këto link-e janë aktive, publikisht të aksesueshëm dhe të përdorshëm nga qytetarët dhe palët e interesuara për paraqitjen e denoncimeve. Ky mekanizëm kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e transparencës, forcimin e mekanizmave të raportimit dhe përmirësimin e aksesit të publikut në instrumentet kundër korrupsionit. Ndërsa nga ana e Strukturës Menaxhuese (SM) për fondet IPARD në Ministrinë e Financave, e cila përfshin DMZKA dhe Fondin Kombëtar dhe SASPAC po punohet në këtë drejtim. Konkretisht DMZKA është në proces planifikimi për krijimin e një linku të dedikuar të publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Është përgatitur një draft paraprak lidhur me përmbajtjen dhe dizajnin fillestar për strukturën e faqes për ndërgjegjësimin mbi raportimin e mashtrimit. SASPAC është në proces ridizenjimi të faqes zyrtare.

Ky aktivitet rezulton në proces zbatimi, në përputhje me afatet e përcaktuara në Planin e veprimit.

Lidhur me zbatimin e **Masës 2.2**, janë parashikuar 3 aktivitete, nga të cilat:

Aktiviteti 2.2.1 “Të vlerësohen nevojat për trajnime në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së dhe të hartohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore”, parashikuar për tu zbatuar në periudhën 2025-2026. Lidhur me zbatimin e këtij aktiviteti, nga ana e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MSHAPA), në cilësinë e institucionit drejtues për këtë aktivitet, në bashkëpunim me DMZKA dhe të gjitha institucionet përkatëse në bashkëpunim me ASPA-n, raportohet se aktualisht nëpërmjet Shkollës së Administratës Publike, ASPA në vlerësim të nevojave për trajnim nga institucionet respektive, ofrohen trajnime mbi mënyrën e aplikimit dhe monitorimit, në lidhje me përdorimin e fondeve të BE-së. Module të cilat ofrohen në kuadër të gjerë për nëpunësit e administratës publike. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) ka ofruar për administratën e pushtetit qendror, pushtetit vendor, si dhe institucioneve të pavarura, trajnime për çështje me natyrë të përgjithshme lidhur me BE-në dhe procesin e Integritimit Evropian, por edhe trajnime për çështje me natyrë specifike lidhur me kapituj të ndryshëm të Acquis.

Konkretisht për vitin 2025, në vijim të nevojave për trajnim, janë hartuar dhe zhvilluar modulet sa vijon:

- Auditimi i fondeve të asistencës së Bashkimit Evropian dhe kërkesat e standarteve ndërkombëtare të auditimit – 145 pjesëmarrës;
- Çështjet Regullatore të BE-së – 93 pjesëmarrës;
- Identifikimi i grupeve të interesit për pjesë të caktuara të procesit të negociatave – 88 pjesëmarrës;
- Institucionet, Politikat dhe Vendimmarrja në Bashkimin Evropian – 190 pjesëmarrës;
- Integrimi Evropian dhe Negociatat e Anëtarësimit – 137 pjesëmarrës;
- Llojet e fondeve të BE dhe menaxhimi i fondeve IPA – 291 pjesëmarrës;
- Llojet e fondeve të BE-së, planifikimi dhe aplikimi për fonde – 502 pjesëmarrës;
- Përafrimi i legjislacionit të BE – 120 pjesëmarrës;
- Përgatitja e planit të përkthimit EU-së Acquis-Detyrimet ligjore dhe kërkesat e BE për përkthimin – 130 pjesëmarrës;
- Qeverisja për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin në BE – 759 pjesëmarrës;
- Vlerësimi dhe Përgatitja e Piketave Hapëse – 119 pjesëmarrës;
- Plotësimi i kurrikulës së ASPA-s për çështjet e BE dhe hyrje në hartimin e planit të programit dhe trajnimit – 18 pjesëmarrës;

Në vijim në kuadër të hartimit të planit të vitit 2026, ASPA ka planifikuar hartimin e kurrikulës specifike duke përfshirë edhe luftën kundër mashtrimit, sikurse parashikuar në **aktivitetin 2.2.2**, dhe **2.2.3**, të cilat do të zbatohet në vijim në periudhën janar - qershor 2026.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezultoi i zbatuar.

Lidhur me zbatimin e **Masës 2.3**, janë parashikuar 2 aktivitete nga të cilat:

Aktiviteti 2.3.1 “Të rishikohet udhëzuesi aktual për zhvillimin e planeve të integritetit në aspektin e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së. Nëse është e nevojshme, të ndryshohet ose plotësohet udhëzuesi dhe të dërgohet tek institucionet/organet publike përkatëse”, parashikuar për t’u zbatuar brenda vitit 2025. Lidhur me zbatimin e këtij aktiviteti, nga ana e Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin (MSHAPA), në cilësinë e institucionit drejtues për këtë aktivitet, në bashkëpunim me DMZKA dhe institucionet/strukturat publike të ngarkuara me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, raportohet se:

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK) ka përgatitur draft-dokumentin “Udhëzues shpjegues për vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet publike, me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së”, i cili ndodhet në procesin e vlerësimit paraprak nga MAPA.

DPAK, pasi ka kryer një analizë teknike mbi boshllëqet dhe sugjerimet për ndryshim, si dhe një konsultim teknik me Ministrinë e Financave dhe institucionet kyçe për faktorët e riskut për t’u përfshirë në metodologji, ka përgatitur draft-udhëzuesin shpjegues. Ky dokument, në ndërveprim me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin nr.334, datë 07.10.2020, të Ministrit të Drejtësisë, do të shërbejë për orientimin e institucioneve në procesin e vlerësimit të riskut dhe hartimit të planeve të masave të integritetit, me fokus parandalimin e mashtrimit në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian, në përputhje me masat dhe aktivitetet e SKKM.

Në përfundim të vlerësimit nga MAPA si institucion drejtues, dokumenti “Udhëzues shpjegues për vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet publike me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së”, parashikohet t’i përcillet për njohje dhe zbatim institucioneve që koordinojnë procese dhe mbajnë marrëdhënie funksionale me strukturat e Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e fondeve, granteve dhe mbështetjes financiare.

Aktiviteti ka arritur objektivin e vendosur dhe është miratuar udhëzuesi "Për vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet publike me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe mbrojtjen e interesave financiare të BE-së". Ky udhëzues do të ndikojë në vijim, në integrimin e masave parandaluese të mashtrimit në planet e integritetit të institucioneve publike.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezultoi i zbatuar.

Lidhur me zbatimin e **Masës 2.5**, janë parashikuar 3 aktivitete, nga të cilat:

Aktiviteti 2.5.1 “Të krijohet dhe forcohet bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Financave me ILDKPKI-në për informimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve mbi bazën e mekanizmit ekzistues të ILDKPKI-së dhe të parashikohen aktivitetet në Strategjinë Ndërsektoriale Antikorrupsion për parandalimin e mashtrimit në përdorimin e fondeve të BE-së”, parashikuar për tu zbatuar në periudhën 2025-2026. Lidhur me këtë aktivitet nga ana e DMZKA, në cilësinë e institucionit drejtues, në bashkëpunim me AFCOS, raportohet se është hartuar nga ana e strukturës drejtuese analiza e mekanizmave ekzistues të ILDKPKI-së për sinjalizimin e mashtrimit, duke përfshirë rishikimin e kuadrit ligjor në fuqi, strukturën institucionale dhe procedurat praktike për trajtimin e

sinjalizimeve. Analiza është fokusuar në funksionimin e kanaleve të brendshme dhe të jashtme të raportimit, rolin mbikëqyrës të ILDKPKI-së, si dhe në mënyrën se si këta mekanizma mund të ndërliohen me aktorë jo-shtetërorë, veçanërisht organizatat e shoqërisë civile, në funksion të parandalimit dhe zbulimit të mashtrimit. Analiza e hartuar do të shërbejë për zbatimin e këtij aktiviteti në mënyrë të strukturuar. Rreziqet e identifikuara lidhen kryesisht me faktin se mekanizmat ekzistues të sinjalizimit janë ndërtuar kryesisht për përdorim institucional dhe individual, dhe jo domosdoshmërisht për një përfshirje të strukturuar të shoqërisë civile. Një rrezik shtesë lidhet me kapacitetet institucionale, si dhe me nevojën për të garantuar ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e raportuesve në rast të ndërmjetësimit nga aktorë jo-shtetërorë.

Në fazën pasuese, që i përket vitit 2026 do të përcaktohen qartë modalitetet e bashkëpunimit ndërmjet ILDKPKI dhe organeve kompetente.

Lidhur me **Aktivitetin 2.5.2** “Të përgatitet plani i angazhimit të shoqërisë civile”, është përgatitur një draft i planit të angazhimit të shoqërisë civile, si dokument pune, i cili synon të strukturojë bashkëpunimin në fushën e parandalimit dhe raportimit të mashtrimit, veçanërisht lidhur me fondet e BE-së. Për periudhën në vijim draft-plani do të dërgohet për konsultim dhe do të vlerësohen mundësitë për sigurimin e burimeve të nevojshme financiare për zbatimin e tij.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezulton pjesërisht i zbatuar, në përputhje me afatin e planifikuar të implementimit, i cili shtrihet përgjatë periudhës 2025–2027.

Treguesit e performancës:

Për këtë objektiv për vitin 2025 janë parashikuar 3 tregues performance sa vijon:

Indikatori		Vlera bazë	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi specifik 2: Nxitja e parandalimit të mashtrimit midis zyrtarëve publikë dhe publikut.				
1	TKP 2.1.1 Linqe të dedikuara në faqen zyrtare përkatëse të internetit në lidhje me raportimin e parregullsisve dhe rasteve të dyshuara të mashtrimit krijuar.	-	Linqet krijuar. 100%	71%.
2	TKP 2.2.1 Kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për etikën dhe integritetin në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së vlerësuar dhe një plan për zhvillimin e	-	Vlerësimi i HRCD përfunduar.	Realizuar 100%

	kapaciteteve të burimeve njerëzore përgatitur dhe miratuar.			
3	KPI 2.5.1 Plani i angazhimit të shoqërisë civile është përfunduar dhe zbatuar.	-	Hartimi i Planit të Angazhimit të Shoqërisë Civile përgatitet dhe miratohet.	Realizuar 100%.

Niveli i realizimit të objektivit 2.

Niveli i realizimit të Objektivit specifik 2: Nxitja e parandalimit të mashtrimit midis zyrtarëve publikë dhe publikut, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën qershor - dhjetor 2025 është 90%.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Nr.O2} = \frac{\text{TKP 2.1.1 (71\%)} + \text{TKP 2.2.1 (100\%)} + \text{KPI 2.5.1 (100\%)}}{3 \text{ TKP}} \times 100\% = 90 \%$$

Niveli i realizimit të objektivit 2 për këtë periudhë raportimi referuar treguesve të performancës është **në masën 90%**.

Shkalla e realizimit të objektivit referuar aktiviteteve është shumë e mirë. (3 aktivitete janë realizuar plotësisht dhe 2 janë në proces realizimi sikurse planifikuar).

Objektivat	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2025			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Aktivitete plotësisht të realizuara	Aktiviteteve në proces realizimi	Aktivitete të pa realizuara
Objektivi 2	Aktivitete	5	3	2	-

- ***Për Objektivin 3: Maksimizimi i efektshmërisë së kontrolleve për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe korrigjimin e mashtrimit, ka të parashikuara 4 masa dhe 11 aktivitete.***

Ky objektiv përfshin 4 masa, konkretisht, sa vijon:

Masa 3.1 Ndarja e mësimëve të nxjerra nga parregullsitë/rastet e mëparshme të dyshuara të mashtrimit ndërmjet zyrtarëve publikë, detyra e të cilëve është mbrojtja e interesave financiare të BE-së për të mësuar nga përvojat e kaluara. Periudha 2025-2027.

Masa 3.2 Miratimi i ARACHNE¹ me qëllimin për të mbështetur autoritetet menaxhuese në kontrollet e tyre administrative dhe kontrollet e menaxhimit, me synimin për të identifikuar, zbuluar dhe parandaluar mashtrimin. Periudha 2026-2028.

Masa 3.3 Rritja e funksionit të menaxhimit të parregullsive (parandalimi, zbulimi, trajtimi dhe raportimi i parregullsive), përfshirë modalitetet e ardhshme të asistencës financiare të BE-së. Periudha 2025-2027.

Masa 3.4. Adresimi i rekomandimeve të Auditimit (Forensik) në lidhje me Programin IPARD. Periudha 2026-2027.

Lidhur me zbatimin e **masës 3.1**, është parashikuar:

Aktiviteti 3.1.1 “Zyra mbështetëse e ZKA-së do të përdorë regjistrin e saj aktual të parregullsive/rasteve të dyshuara të mashtrimit për të ndarë mësimet e nxjerra me zyrtarët publikë përkatës, detyra e të cilëve është mbrojtja e interesave financiare të BE-së”, e cila është parashikuar për t’u zbatuar në periudhën 2025-2027. DMZKA, në cilësinë e institucionit drejtues për këtë aktivitet, raporton se ka realizuar analizën e të dhënave nga regjistrat ekzistues dhe ka identifikuar raste përfaqësuese për nxjerrjen e mësimëve. Aktiviteti është zhvilluar sipas planifikimit dhe nuk janë hasur vështirësi të rëndësishme gjatë zbatimit. Në vijim, mësimet e nxjerra do të ndahen me aktorët e tjerë institucionalë dhe do të ndërliidhen me masat e ndërgjegjësimit dhe portalin informues, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave të parandalimit të mashtrimit. Nga DMZKA është përgatitur kalendari i zbatimit, ku gjatë nëntor–dhjetor 2025 u hartua drafti i dokumentit “Lessons Learned” dhe në dhjetor u përgatit lista e institucioneve për shpërndarje. Për vitin 2025 ky dokument dhe mësimet e nxjerra u trajtuan me strukturat e MFE, në total 40 punonjës.

Gjatë periudhës Janar-Mars 2026 është parashikuar realizimi i aktivitetit për prezantimin ndërinstytucional të materialit, i cili aktualisht është në proces zbatimi.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezultoi i zbatuar.

Lidhur me zbatimin e **masës 3.3**, janë parashikuar 3 aktivitete, respektivisht:

¹ ARACHNE është një mjet i integruar i TI-së për nxjerrjen e të dhënave dhe pasurimin e të dhënave të krijuara nga KE-ja

Aktivitetin 3.3.1 Të identifikohen zyrtarët publikë, detyra e të cilëve lidhet me fushën e menaxhimit të parregullsive, të vlerësohen kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore dhe mangësitë e aftësive dhe të përgatitet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përfshirë modalitetet e ardhshme të ndihmës financiare të BE-së; periudha e zbatimit 2025-2026.

Në kuadër të realizimit të këtij aktiviteti, janë identifikuar zyrtarët publikë, detyra e të cilëve lidhet me fushën e menaxhimit të parregullsive. Në vlerësim të kapaciteteve ekzistuese dhe mangësive u përgatit dhe u realizuar trajnim i dedikuar në datat 3-4 qershor me temë: “Training Session on the New Guideline for Irregularity Management”. Gjatë këtyre sesioneve u trajnuan 40 pjesëmarrës mbi “Irregularity Management under IPA III and IPARD II Programmes”.

Aktivitetin 3.3.2 Të përgatiten udhëzime për zbatimin e trajnimeve në lidhje me fushën e menaxhimit të parregullsive, përfshirë modalitetet e ardhshme të asistencës financiare të BE-së, për periudhën 2025-2026.

Në kuadër të realizimit të këtij aktiviteti është punuar lidhur me hartimin e një guide/udhëzuesi të ri për menaxhimin e parregullsive për të cilin u trajnuan në vijim strukturat përgjegjëse.

Aktivitetin 3.3.3 Të kryhen trajnime në fushën e menaxhimit të parregullsive në përputhje me planin e zhvillimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore, ku 2 aktivitetet e para janë të parashikuara për periudhën 2025-2026 dhe aktiviteti i fundit ka shtrirje për periudhën 2025-2027.

Në kuadër të realizimit të këtij objekti u realizuan trajnime të dedikuara në datat 3-4 qershor me temë: “Training Session on the New Guideline for Irregularity Management”. Gjatë këtyre sesioneve u trajnuan 40 pjesëmarrës mbi “Irregularity Management under IPA III and IPARD II Programmes”.

Në periudhën pasuese do të ndërmerren hapat e parashikuara, në bashkëpunim me institucionet përkatëse. Procesi është parashikuar të zhvillohet dhe për periudhën në vijim.

Lidhur me zbatimin e masës 3.4, e cila edhe pse është parashikuar për zbatim në periudhën 2026-2027, rezulton se:

Është ndërmarrë Aktiviteti 3.4.1, i cili lidhet me vlerësimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve përkatëse. DMZKA si institucioni drejtues, procesi ka nisur me ngritjen e një grupi të dedikuar pune ndërmjet Ministrisë së Financave dhe AZHBR-së. Në vijim, puna e këtij grupi është fokusuar në analizimin e detajuar të Raportit Përfundimtar të Auditimit Forensik (FTI) dhe identifikimin e gjetjeve dhe rekomandimeve me qëllim hartimin e një plani veprimi.

Përgjatë këtij procesi, janë zhvilluar takime dhe diskutime të vazhdueshme, të cilat kanë mundësuar një rishikim të thelluar dhe përmirësim progresiv të planit, duke siguruar që të gjitha masat e propozuara të jenë të plota, të qëndrueshme dhe të zbatueshme në praktikë.

Në përfundim të këtij procesi, Plani i përditësuar i Veprimit është miratuar nga NAO dhe më pas është dërguar për shqyrtim në Komisionin Evropian, duke shënuar një hap të rëndësishëm në

drejtim të adresimit të rekomandimeve dhe forcimit të mëtejshëm të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të Programit IPARD.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezulton i zbatuar.

Treguesit e performancës:

Lidhur me këtë objektiv janë parashikuar 4 tregues performance sa vijon:

Indikatori		Vlera bazë	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi specifik 3: Maksimizimi i efikasitetit të kontrolleve për parandalimin, zbulimin dhe raportimin dhe korrigjimin e mashtrimit.				
1	TKP 3.1.1 Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në sesionet e ndarjes së mësimave të nxjerra.		50 zyrtarë	80%
2	TKP 3.3.1 Vlerësohen kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për menaxhimin e parregullsisve dhe hartohet dhe miratohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.		Vlerësimi i HRCD përfunduar.	100%
3	TKP 3.3.5 Përqindja e raporteve të parregullsisve dorëzuar në përputhje me afatet e përcaktuara në procedurën e menaxhimit të parregullsisve në seksionin përkatës të manualit të procedurave.		60%.	Realizuar 100 %
4	TKP 3.3.6 Të drejtat e përdoruesve në sistemin IMS monitoruar, duke marrë parasysh përdoruesit e rinj dhe vazhdimësinë e punës.		Marrëveshjet e monitorimit krijuar.	Realizuar 100 %

Niveli i realizimit të objektivit 3.

Niveli i realizimit të Objektivit specifik 3: Maksimizimi i efikasitetit të kontrolleve për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe korrigjimin e mashtrimit, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën qershor - dhjetor 2025 është 95%.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Nr.O3} = \frac{\text{TKP 3.1.1 (80\%)} + \text{TKP 3.3.1 (100\%)} + \text{TKP 3.3.5 (100\%)} + \text{TKP 3.3.6 (100\%)}}{4} \times 100\% = 95 \%$$

4 TKP

Niveli i realizimit të objektivit 3 për këtë periudhë raportimi është **në masën 95%** referuar treguesve të performancës.

Shkalla e realizimit referuar realizimit të aktiviteteve të parashikuara është shumë e mirë. Aktivitetet e parashikuara janë realizuar në masën 100 %.

Objektivat	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2025			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Aktivitete plotësisht të realizuara	Aktiviteteve në proces realizimi	Aktivitete të pa realizuara
Objektivi 3	Aktivitete	4	4	0	0

Për Objektivin 4: Forcimi i funksioneve aktuale të hetimit dhe të ndjekjes penale, janë parashikuar 2 masa dhe 7 aktivitete.

Ky objektivi përfshin, konkretisht masat sa vijon:

Masa 4.1 Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimi i aftësive të stafit përgjegjës për hetime dhe sigurimi i vazhdimësisë së stafit. Periudha 2025-2027.

Masa 4.2 Zhvillimi dhe zbatimi i një Politike Motivuese (bonus) për të gjitha autoritetet/strukturat përgjegjëse për menaxhimin e Programeve IPA III të financuara nga Programi Shumëvjeçar IPA III (Programet Operacionale) në përputhje me Udhëzimin e DG Near, përfshirë autoritetet/strukturat e përfshira në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së të përshkruara në Marrëveshjen Kuadër të Partneritetit Financiar (FFPA). Periudha 2025-2026.

Lidhur me zbatimin e **masës 4.1**, janë planifikuar 2 aktivitete, konkretisht:

Aktiviteti 4.1.1 “Të vlerësohen kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore dhe i mangësive të aftësive” dhe **Aktiviteti 4.1.2** “Të hartohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, të planifikohen programe të trajnimit të synuara për të forcuar funksionet aktuale të hetimit dhe ndjekjes penale”, parashikuar për t’u zbatuar gjatë periudhës 2025-2026.

Lidhur me zbatimin e këtyre aktiviteteve nga ana strukturave drejtuese: DMZKA dhe AFCOS si dhe strukturat e tjera si DFK, Autoritetet Menaxhuese, AZHBR, NJQFK, DPD, PP, SPAK, Policia e Shtetit Shqiptar dhe institucionet/organet publike të ngarkuar me interesat financiare të BE-së, raportohet se është punuar për përcaktimin e përbërjes dhe roleve të grupit të punës në bashkëpunim me strukturat përkatëse. Janë përdorur koncepte dhe përvoja ekzistuese, përfshirë mësimet e nxjerra nga zbatimi i sistemeve IPARD, dhe janë dërguar kërkesa për input tek aktorët relevantë. Në vijim, procesi do të vazhdojë duke u mbështetur në informacionin ekzistues dhe përvojat e mëparshme, me qëllim finalizimin gradual të planit të zhvillimit të kapaciteteve.

Në të njëjtën kohë është realizuar vlerësimi i nevojave për trajnim nga institucionet respektive. Konkretisht është hartuar pyetësori i nevojave për trajnim i cili i është dërguar institucioneve respektive. Në vijim të informacionit të mbledhur është bërë identifikimi i temave kryesore dhe nevojave respektive për trajnim. Aktualisht jemi në proces diskutimi me ASPA lidhur me përfshirjen e këtyre temave në modulet e trajnimit që do të zhvillohen në periudhën në vijim.

Pra: Vlerësimi i HRCD ka përfunduar. Bazuar në të dhënat aktuale, është kryer një vlerësim dhe analizë paraprake. Është hartuar formulari për identifikimin e nevojave për trajnim për secilin institucion të përfshirë dhe është marrë feedback nga institucionet lidhur me nevojat e tyre specifike. Aktualisht po planifikohet realizimi i trajnimit.

Këto aktivitete për periudhën raportuese vlerësohen të zbatuara.

Lidhur me **masën 4.2**, për zbatimin e të cilës janë parashikuar 3 aktivitetet sa vijon:

Aktiviteti 4.2.1: Vlerësimi i strukturave dhe personelit të përfshirë në menaxhimin e Programeve IPA III, përfshirë autoritetet e përfshira në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së;

Aktiviteti 4.2.2: Vlerësimi i buxhetit të tre Programeve Operative në kuadër të Asistencës Teknike, për të përcaktuar përqindjen e bonusit që do të sigurohet për çdo kategori personeli në baza vjetore, si dhe

Aktiviteti 4.2.3: Hartimi i një Vendimi të Këshillit të Ministrave për bonusin për autoritetet e përfshira në menaxhimin dhe kontrollin e Programeve Operacionale IPA III.

Për periudhën raportuese viti 2025 raportohet se: Në kuadër të kësaj mase është përgatitur drafti i politikës së mbajtjes së stafit, bazuar në analizën e qarkullimit të personelit dhe rezultatet e një ankete anonime me punonjësit. Dokumenti është hartuar nga një grup pune ndër-institucional dhe është harmonizuar me kuadrin ligjor dhe strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kërkesat e sistemeve të menaxhimit të fondeve të BE-së.

Deri më 31 dhjetor 2025, politika ishte në fazë drafti të avancuar, i cili u finalizua në fillim të vitit pasues. Rreziqet kryesore lidheshin me procesin e koordinimit dhe miratimit institucional, si dhe me nevojën për zbatim të qëndrueshëm dhe të njëtrajtshëm në të gjitha strukturat përkatëse. Dokumenti ju nënshtrua konsultimit dhe miratimit formal, si dhe shoqërohet me një plan zbatimi dhe mekanizma monitorimi për vlerësimin e ndikimit të tij.

Numri i personelit të identifikuar për menaxhimin e programeve IPA III është i identifikuar dhe përcaktuar në projekt-vendimin përkatës, realizuar dhe bashkërenduar me institucionet e përfshira. Aktualisht është në fazën e dërgimit për miratim në KM.

Për periudhën raportuese, ky aktivitet rezultoi i zbatuar.

Lidhur me realizimin e këtij objekti për vitin 2025 ishin parashikuar 4 tregues performance sa vijon:

Indikatori	Vlera bazë	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi specifik 4: Forcimi i funksioneve aktuale të hetimit dhe ndjekjes penale.			
1	TKP.4.1 1. Kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për hetime dhe ndjekje penale për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, të vlerësuara, si dhe plani për mbrojtjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore i krijuar dhe i miratuar.		Vlerësimi i HRCD përfunduar. Realizuar 100 %
2	TKP 4.1.4 Përqindja e institucioneve/organeve që kanë krijuar një plan të vazhdimësisë së biznesit dhe kanë miratuar një politikë motivuese të stafit.		Rritje në krahasim me një vit më parë. Realizuar 100%
3	TKP 4.2.1 Numri i përgjithshëm i strukturave dhe personelit të identifikuar të përfshirë në menaxhimin e Programeve IPA III, përfshirë autoritetet e përfshira në mbrojtjen e interesit financiar të BE-së.		Numri total i strukturave dhe stafit identifikuar. Realizuar 100 %
4	TKP 4.2.2 Miratimi i buxhetit vjetor, përfshirë bonusin në asistencën teknike të programeve të operacionit, qarkullimin vjetor të personelit në funksionet e kontrollit dhe hetimit.		Numri total i strukturave dhe stafit identifikuar. Realizuar 100 %

Niveli i realizimit të objektivit 4.

Niveli i realizimit të Objektivit specifik 4: Maksimizimi i efikasitetit të kontrolleve për parandalimin, zbulimin dhe raportimin dhe korrigjimin e mashtrimit, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën qershor - dhjetor 2025 është 100 %.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Nr.O4} = \frac{\text{TKP 4.1.1 (100\%)} + \text{TKP 4.1.4 (100\%)} + \text{TKP 4.2.1 (100\%)} + \text{TKP 4.2.2 (100\%)}}{4 \text{ TKP}} \times 100\% = 100 \%$$

Niveli i realizimit të objektivit 4 për këtë periudhë raportimi është **në masën 100%**.

Shkalla e realizimit të aktiviteteve të planifikuara është shumë e mirë, me aktivitet të realizuara në masën 100%.

Objektivat	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2025			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Aktivitete plotësisht të realizuara	Aktiviteteve në proces realizimi	Aktivitete të pa realizuara
Objektivi 4	Aktivitete	5	5	0	0

- *Për Objektivin 5: Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm rikuperimi për humbjet e shkaktuara, është parashikuar 1 masë dhe 3 aktivitete, të cilat janë parashikuar të fillojnë zbatimin në vitin 2026 dhe të vijojnë deri në vitin 2027.*

Masa 5.1 konsiston në “Analizimin e rasteve të parregullsive dhe mashtrimeve (të dyshuara) të cilat janë ende në proces rikuperimi dhe zbatimi i masave që sigurojnë një rikuperim më efikas të fondeve”, me institucion/strukturë lider Fondin Kombëtar dhe bashkëpunues institucionin e AZHBR-së dhe CFCU.

1.7 Shkalla e realizimit të aktiviteteve të parashikuara për vitin 2025, paraqitet sa vijon:

Në mënyrë tabelare paraqiten objektivat, masat dhe aktivitetet respektive që kanë filluar zbatimin në vitin 2025 dhe statusi i zbatimit të tyre, për periudhën raportuese.

Tabela nr.1:

Objektivat	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve për vitin 2025			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Aktivitete plotësisht të realizuara	Aktiviteteve në proces realizimi	Aktivitete të pa realizuara
Objektivi 1	Masa	2	2	-	-
	Aktivitete	2			
Objektivi 2	Masa	4	3	2	-
	Aktivitete	5			
Objektivi 3	Masa	2	4	0	0
	Aktivitete	4			
Objektivi 4	Masa	2	5	0	0
	Aktivitete	5			
Objektivi 5	Masa	-	-	-	-
	Aktivitete	-			
Total	Masa	10	14	2	0
	Aktivitete	16			

Grafiku i realizimit të aktiviteteve të parashikuara



1.8 Indiktorët e performancës

Objektivi specifik 1: Sigurimi i një mjedisi të mbrojtur nga mashtrimi nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm.

Lidhur me këtë objektivi për vitin 2025 është parashikuar indikatori:

TKP 1.3.1 Analiza e Rrjetit AFCOS. Për vitin 2025 analiza e rrjetit AFCOS ka filluar ndaj ky indikator është realizuar në masën 100%.

Niveli i realizimit të objektivit 100%.

Objektivi specifik 2: Nxitja e parandalimit të mashtrimit midis zyrtarëve publikë dhe publikut.

Lidhur me këtë objektivi janë parashikuar 3 tregues performance.

TKP 2.1.1 Linqe të dedikuara në faqen zyrtare përkatëse të internetit në lidhje me parregullsitë dhe raportet e rasteve të dyshuara të mashtrimit krijuar. Treguesi i synuar për vitin 2025: Linqet krijuar dhe raportet publikuar. Nga 7 institucione të parashikuara, 5 prej tyre kanë të krijuar linkun respektiv. Realizimi është në masën 71%.

Këto 5 struktura kanë një link të dedikuar në faqen zyrtare të institucionit respektiv, i cili mundëson raportimin e parregullsive dhe rasteve të dyshuara të mashtrimit. Këto link-e janë aktive, publikisht të aksesueshëm dhe të përdorshëm nga qytetarët dhe palët e interesuara për paraqitjen e denoncimeve. Ky mekanizëm kontribuon drejtpërdrejt në rritjen e transparencës, forcimin e mekanizmave të raportimit dhe përmirësimin e aksesit të publikut në instrumentet kundër korrupsionit.

TKP 2.2.1 Kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për etikën dhe integritetin në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së vlerësuar dhe një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore përgatitur dhe miratuar. Treguesi i synuar për vitin 2025: Vlerësimi i HRCD përfunduar. Në planin e trajnimit të vitit 2026 janë planifikuar 3 ëëbinare gjatë periudhës maj - dhjetor 2026. Ky indikator është i realizuar 100%.

KPI 2.5.1 Plani i angazhimit të shoqërisë civile është përfunduar dhe zbatuar. Treguesi i synuar për vitin 2025: Plani i Angazhimit të Shoqërisë Civile përgatitet dhe miratohet. Ky tregues rezulton i zbatuar. Është hartuar plani i Angazhimit të Shoqërisë Civile. Ky indikator është i realizuar 100%.

Niveli i realizimit të objektivit është në masën 90%.

Objektivi specifik 3: Maksimizimi i efikasitetit të kontroleve për parandalimin, zbulimin dhe raportimin dhe korigjimin e mashtrimit.

Lidhur me këtë objektivi janë parashikuar 5 tregues performance.

TKP 3.1.1 Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në sesionet e ndarjes së mësimave të nxjerra. Vlera e synuar për vitin 2025 ka qenë në masën 50 punonjës/zyrtarë. Ky indikator është realizuar në masën 80%.

TKP 3.3.1 Vlerësohen kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për menaxhimin e parregullsisve dhe hartohet dhe miratohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore. Vlera e synuar për vitin 2025 ka qenë Vlerësimi i HRCD përfunduar. Ky indikator është realizuar në masën 100%.

TKP 3.3.5 Përqindja e raporteve të parregullsisve dorëzuar në përputhje me afatet e përcaktuara në procedurën e menaxhimit të parregullsisve në seksionin përkatës të manualit të procedurave. Vlera e synuar për vitin 2025 ka qenë në masën 60%. Aktualisht për periudhën raportuese 100% e raporteve janë dorëzuar në përputhje me afatet e përcaktuara në manualin e procedurave. Ky indikator është realizuar në masën 100 %.

TKP 3.3.6 Të drejtat e përdoruesve në sistemin IMS monitoruar, duke marrë parasysh përdoruesit e rinj dhe vazhdimësinë e punës. Vlera e synuar ka qenë krijimi i userave për përdoruesit e rinj. Për të gjithë përdoruesit e rinj, në vijim të kërkesave të strukturave respektive janë krijuar userat respektiv. Ky indikator është realizuar në masën 100%.

Niveli i realizimit të këtij objekti është në masën 95 %

Objekti specifik 4: Forcimi i funksioneve aktuale të hetimit dhe ndjekjes penale.

Lidhur me këtë objektiv janë parashikuar 4 tregues performance.

TKP.4.1.1. Kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për hetime dhe ndjekje penale për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, të vlerësuara, si dhe plani për mbrojtjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore i krijuar dhe i miratuar. Vlera e synuar për vitin 2025. Rezulton se Vlerësimi i HRCD ka përfunduar. Ky indikator është realizuar në masën 100%.

TKP 4.1.4 Përqindja e institucioneve/organeve që kanë krijuar një plan të vazhdimësisë së biznesit dhe kanë miratuar një politikë motivuese të stafit. Vlera e synuar për vitin 2025. Rritje në krahasim me një vit më parë. Për vitin aktual është përgatitur politika e mbajtjes së stafit, bazuar në analizën e qarkullimit të personelit dhe rezultatet e një ankete anonime me punonjësit. Dokumenti është hartuar nga një grup pune ndër-institucional dhe është harmonizuar me kuadrin ligjor dhe strategjik për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kërkesat e sistemeve të menaxhimit të fondeve të BE-së. Ky indikator është realizuar në masën 100%.

TKP 4.2.1 Numri i përgjithshëm i strukturave dhe personelit të identifikuar të përfshirë në menaxhimin e Programeve IPA III, përfshirë autoritetet e përfshira në mbrojtjen e interesit financiar të BE-së. Vlera e synuar për vitin 2025 ka qenë: Numri total i strukturave dhe stafit identifikuar. Numri i personelit të angazhuar për menaxhimin e programeve IPA III është identifikuar dhe përcaktuar në projekt-vendimin përkatës, realizuar dhe bashkërenduar me institucionet e përfshira. Ky indikator është realizuar në masën 100%.

TKP 4.2.2 Miratimi i buxhetit vjetor, përfshirë bonusin në asistencën teknike të programeve të operacionit, qarkullimin vjetor të personelit në funksionet e kontrollit dhe hetimit. Vlera e synuar ka qenë: Buxheti vjetor përgatitur dhe miratuar. Buxheti për bonusin është përcaktuar në projekt-vendimin përkatësi cili është dërguar për miratim në KM. Ky indikator është realizuar në masën 100%.

Niveli i realizimit të këtij objekti është në masën 100%.

Objekti specifik 5: Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm rikuperimi për humbjet e shkaktuara. Lidhur me këtë objekt për vitin 2025 nuk janë parashikuar tregues performance.

Në mënyrë të përmbledhur treguesit kryesor të performancës, për vitin 2025, pasqyrohen në tabelën sa vijon:

Tabela nr. 2

Indikator		Vlera bazë	Vlera e synuar 2025	Vlera faktike 2025
Objektivi specifik 1: Sigurimi i një mjedisi të mbrojtur nga mashtrimi nëpërmjet krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm.				
1	TKP 1.3.1 Analiza e Rrjetit AFCOS.	-	Analiza filluar.	Realizuar 100%.
Objekti specifik 2: Nixtja e parandalimit të mashtrimit midis zyrtarëve publikë dhe publikut.				
1	TKP 2.1.1 Linqe të dedikuara në faqen zyrtare përkatëse të internetit në lidhje me raportimin e parregullsisve dhe rasteve të dyshuara të mashtrimit krijuar.	-	Linqet krijuar. 100%	71%.
2	TKP 2.2.1 Kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për etikën dhe integritetin në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së vlerësuar dhe një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore përgatitur dhe miratuar.	-	Vlerësimi i HRCD përfunduar.	Realizuar 100%

3	KPI 2.5.1 Plani i angazhimit të shoqërisë civile është përfunduar dhe zbatuar.	-	Plani i Angazhimit të Shoqërisë Civile përgatitet dhe miratohet.	Realizuar 100%.
---	--	---	--	-----------------

Objektivi specifik 3: Maksimizimi i efikasitetit të kontrolleve për parandalimin, zbulimin dhe raportimin dhe korigjimin e mashtrimit.


1	TKP 3.1.1 Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve në sesionet e ndarjes së mësimave të nxjerra.		50 zyrtarë.	80%
2	TKP 3.3.1 Vlerësohen kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për menaxhimin e parregullsisve dhe hartohet dhe miratohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.		Vlerësimi i HRCD përfunduar.	100%
3	TKP 3.3.5 Përqindja e raporteve të parregullsisve dorëzuar në përputhje me afatet e përcaktuara në procedurën e menaxhimit të parregullsisve në seksionin përkatës të manualit të procedurave.		60%.	100%
4	TKP 3.3.6 Të drejtat e përdoruesve në sistemin IMS monitoruar, duke marrë parasysh përdoruesit e rinj dhe vazhdimësinë e punës.		Marrëveshjet e monitorimit krijuar.	100%

Objektivi specifik 4: Forcimi i funksioneve aktuale të hetimit dhe ndjekjes penale.

1	TKP.4.1 1. Kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore për hetime dhe ndjekje penale për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, të vlerësuara, si dhe plani për mbrojtjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore i krijuar dhe i miratuar.		Vlerësimi i HRCD përfunduar.	100%
2	TKP 4.1.4 Përqindja e institucioneve/organeve që kanë krijuar një plan të vazhdimësisë së biznesit dhe kanë miratuar një politikë motivuese të stafit.		Rritje në krahasim me një vit më parë.	100%

3	TKP 4.2.1 Numri i përgjithshëm i strukturave dhe personelit të identifikuar të përfshirë në menaxhimin e Programeve IPA III, përfshirë autoritetet e përfshira në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.		Numri total i strukturave dhe stafit identifikuar.	100%
4	TKP 4.2.2 Miratimi i buxhetit vjetor, përfshirë bonusin në asistencën teknike të programeve të operacionit, qarkullimin vjetor të personelit në funksionet e kontrollit dhe hetimit.		Numri total i strukturave dhe stafit identifikuar.	100%

Grafiku i realizimit të objektivave



1.9 Buxheti dhe kostot financiare në kuadër të zbatimit të Planit të veprimit të SKKM-së, për vitin 2025.

Për periudhën raportuese, nga ana e institucioneve dhe strukturave të ngarkuara për zbatimin e objektivave, masave dhe aktiviteteve respektive, është raportuar se aktivitetet janë zbatuar nga stafi/personeli i institucioneve/strukturave përkatëse të ngarkuara për zbatim pra me kosto administrative dhe jo nga donatorë të jashtëm.

1.9 Fushat ku janë identifikuar problematika gjatë implementimit dhe propozimet për përmirësim:

- **Lidhur me zbatimin e masës 1.1**, është parashikuar Aktiviteti 1.1.1, “Të kryhet një analizë e kuadrit ligjor aktual, për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e mashtrimit”, parashikuar për t’u zbatuar në periudhën 2025-2026, nga ana e Drejtorisë Mbështetëse të

Zyrtarit Kombëtar Autorizues (DMZKA), në cilësinë e Institucionit drejtues për këtë aktivitet është evidentuar si risk që numri i komenteve të marra lidhur me analizën e kuadrit ligjor aktual, për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe sanksionimin e mashtrimit ka qenë i kufizuar, duke reflektuar vështirësi strukturore në angazhimin aktiv të institucioneve. Kjo rrezikon vonesa në konsolidimin e analizës dhe përdorimin e saj si bazë për masa të mëtejshme.

Gjithsesi do të vijohet procesi i komunikimit zyrtar, me qëllim marrjen e inputeve shtesë dhe finalizimin e dokumentit, i cili do të shërbejë si referencë për përmirësime të mëtejshme të kuadrit institucional.

- **Lidhur me zbatimin e Masës 2.1**, Aktiviteti 2.1.1 “Publikimi i informacionit të përditësuar në faqet përkatëse zyrtare, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me parregullsitë dhe rastet e dyshimta të mashtrimit në lidhje me përdorimin e fondeve të BE-së”, parashikuar për tu zbatuar në periudhën 2025-2027, nga ana e Drejtorisë Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues (DMZKA), në cilësinë e Institucioni drejtues për këtë aktivitet, nuk janë identifikuar risqe madhore në zbatim, megjithatë sfidë mbetet sigurimi i koherencës së përmbajtjes dhe aksesueshmërisë së saj për të gjithë aktorët relevantë.

Në vijim, përmbajtja do të konsultohet dhe dakordësohet me strukturat e tjera të përfshira, si do të integrohet plotësisht me masat e tjera, përfshirë ndarjen e informacionit mbi mekanizmat e raportimit dhe mësimet e nxjerra.

- **Lidhur me zbatimin e masës 4.1** “Zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, ngritja e aftësive të personelit përgjegjës për hetime dhe sigurimi i vazhdimësisë së biznesit”, për zbatimin e të cilës janë planifikuar të fillojnë implementimin 2 aktivitete, konkretisht Aktiviteti 4.1.1 Të vlerësohen kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore dhe i mangësive të aftësive dhe Aktiviteti 4.1.2 Të hartohet një plan për zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, të planifikohen programe të trajnimit të synuara për të forcuar funksionet aktuale të hetimit dhe ndjekjes penale, parashikuar për tu zbatuar gjatë periudhës 2025-2026, nga ZMZKA (drejtues) dhe AFCOS (drejtues), risku kryesor lidhet me disponueshmërinë e burimeve financiare për zbatimin e trajnimeve dhe mundësinë e përfshirjes së tematikave respektive në modulet e trajnimit të zhvilluara nga ASPA.
- **Lidhur me masën 4.2:** Zhvillimi dhe zbatimi i një Politike Motivuese (bonus) për të gjitha autoritetet/strukturat përgjegjëse për menaxhimin e Programeve IPA III të financuara nga Programi Shumëvjeçar IPA III (Programet Operacionale) në përputhje me Udhëzimin e DG Near, përfshirë autoritetet/strukturat e përfshira në mbrojtjen e interesave financiare të BE-së të përshkruara në Marrëveshjen e Partneritetit të Kornizës Financiare (FFPA), për zbatimin e të cilës janë parashikuar 3 aktivitete, risqet kryesore lidhen me nevojën për zbatim të qëndrueshëm dhe të njëtrajtshëm në të gjitha strukturat përkatëse.

Lista e akronimeve

AAPAA	Autoriteti i Auditimit të Programeve të Asistencës të Akredituar nga BE-ja
AIF	Agjencia e Inteligjencës Financiare
FK	Fondi Kombëtar (i referuar edhe si Organ Kontabël)
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Ministria e Financave)
AFCOS	Shërbimi i Koordinimit Kundër Mashtrimit, në Ministrinë e Financave
AFIS	Sistemi Informativ për luftën Kundër Mashtrimit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BN	Bashkëpunimi Ndërkufitar
NJQFK	Njësia Qendrore e Financimeve dhe Kontraktimeve (e referuar edhe si organ i ndërmjetëm për menaxhimin financiar/ONMF)
DP/HKBF	Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Raportimit Financiar.
COSO	Komiteti i Organizatave Sponsorizuese
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
MSHAPA	Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
DIFP	Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik, në Ministrinë e Financave, që vepron si Shërbimi i Koordinimit Kundër Mashtrimit/AFCOS
ZPPE	Zyra e Prokurorit Publik Evropian
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Ministria e Financave)
PP	Prokuroria e Përgjithshme
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
ZHKBNJ	Zhvillimi i Kapaciteteve të Burimeve Njerëzore
ONMF	Organi i Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar
SMP	Sistemi i Menaxhimit të Parregullive
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
IPA FËA	Instrumenti për Marrëveshjen Kuadër të Para-Anëtarësimit
IPARD	Instrumenti për Ndihmën e Para-Anëtarësimit për Zhvillimin Rural

SNKK	Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit
AM	Autoritetet Menaxhuese
SKKM	Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ZKA/NAO	Zyrtari Kombëtar Autorizues
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
OLAF	Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit
PACA	Konstatimet Parësore Administrative ose Gjyqësore
PIF	Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Evropian
PMO	Kryeministria
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SPAK	Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
TFEU	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian